

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8281
E enjte, 16 prill 2026
Çmimi 0.50 €

Joseph: Kurti të heqë dorë nga popullizmi përçarës dhe të përfitojë nga dobësimi i Vuçiqit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KONJUFCA PËR ÇËSHTJEN E PRESIDENTIT: SHKOJMË NË ZGJEDHJE NËSE KY ËSHTË VULLNETI I OPOZITËS



Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Glauk Konjufca, tha se çështja e zgjedhjes së presidentit të ri të

vendit varet nga vullneti i partive opozitare. "Shkojmë në zgjedhje të reja nëse ky është vullneti i opozitës. Nuk kemi çfarë të bëjmë", tha ai për mediet

të mërkurën. Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se është në kontakt me kërret e partive opozitare, e "kur ka rezultate atëherë ju njoftojmë"

AKTUALE




TRUMPI THOTË SE NUK PLANIFIKON ZGJATJEN E ARMËPUSHIMIT ME IRANIN

KURTI: SOT 11 410 BIZNESE JANË AKTIVE NË SEKTORIN E EKONOMISË DIGJITALE DHE TË SHËRBIMEVE PROFESIONALE

ABDIXHIKU ZGJEDH KRYESINË E RE TË LDK-së

EKONOMI



DELEGACIONI I BQK-së TAKOHET ME DREJTUESIT E DEPARTAMENTIT PËR TREGJET E PARASË DHE KAPITALIT TË FMN-së

KONFIRMOHET RASTI I PARË I SËMUNDJES LIJA E DELEVE/DHIVE (SHEEP POX/GOATPOX) NË KOSOVË

SPORT



KOSOVA SYNON MEDALJE NË KAMPIONATIN EVROPIAN TË XHUDOS



KËRKOHET PEZULLIMI I PROCESIT PËR BORDIN E KPM-së DHE TË RTK-së



PROKURORIA KËRKON BURGIM TË PËRJETSHËM PËR TË AKUZUARIT NË RASTIN 'BANJSKA'

RENOVA
PUTZ
Macedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI THOTË SE NUK PLANIFIKON ZGJATJEN E ARMËPUSHIMIT ME IRANIN

WASHINGTON, 15 PRILL - Presidenti amerikan Donald Trump tha se nuk planifikon që ta zgjasë armëpushimin dyjavor me Iranin. "Mund të përfundojë në të dyja mënyrat, por unë mendoj se më e preferueshme është një marrëveshje sepse më pas ata mund të rindërtohen", tha Trumpi në një intervistë dhënë mbrëmjen e 14 prillit për "ABC News". Të dyja palët arritën një marrëveshje më 7 prill për t'i dhënë fund luftës që nisi më 28 shkurt me sulmet e ShBA-së dhe Izraelit ndaj Iranit. Marrëveshja e armëpushimit synon t'u japë palëve kohë për bisedime të paqes dhe një

raund bisedimesh u mbajt fundjavën e kaluar në Islamabad. Gjatë negociatave më 11-12 prill, ShBA-ja dhe Irani nuk arritën një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës. Ndërkaq, më herët gjatë 14 prillit, Trumpi sugjeroi se një raund i ri bisedimesh me Iranin mund të mbahet pas një ose dy ditësh. "Duhet të qëndroni aty, sepse diçka mund të ndodhë gjatë dy ditëve të ardhshme dhe ne jemi më të prirë që të shkojmë atje [sesa në një vend tjetër]", citohet të ketë thënë Trump për "Washington Post", duke iu referuar Islamabadit, teksa



armëpushimi po shkon drejt fundit.

Mediet më herët gjatë së martës raportuan se Pakistani

po synon që të ndërmjetësojë një raund të ri bisedimesh më vonë gjatë javës.

Raportimet erdhën pas një

interviste në të cilën nënpresidenti amerikan JD Vance rriti mundësitë për takime të mëtejme, duke theksuar se "shumë përparim" u arrit gjatë bisedimeve më 11-12 prill.

Një nga çështjet kyçe është mbyllja e Ngushticës së Hormuzit nga Irani, rrugë ujore ku para se të niste lufta kalonte një e pesta e dërgesave globale të naftës dhe gazit.

Pasi bisedimet në Islamabad përfunduan pa marrëveshje, Trumpi njoftoi se ShBA-ja do ta bllokonte ngushticën dhe do të shënjestronte anijet që nisen nga Irani ose drejt Republikës Islamike.

FUNDI I STREHËS SË SIGURT? HUNGARIA NDRYSHON TONIN PËR GRUEVSKIN

BUDAPEST, 15 PRILL - Herën tjetër kur të dërgojnë një kërkesë për ekstradimin e Nikolla Gruevskit, ish-kryeministrit të dënuar të Maqedonisë së Veriut, autoritetet në Shkup mund të marrin një përgjigje pozitive nga Hungaria. Ndryshimi i pushtetit në vendin ku Gruevski u arratis në vitin 2018, mund të mundësojë që ai, më në fund, ta vuajë dënimin dyvjeçar.

Këtë e konfirmoi edhe kryeministri i ardhshëm hungarez, Peter Magyar, i cili tha se Hungaria nuk do të jetë strehë për kriminelët ndërkombëtarë. Duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve për ekstradimin e mundshëm të dy politikanëve polakë, Zbigniew Ziobro dhe Marcin Romanowski, Magyar tha se "në Hungari nuk duhet të blejnë mobilie nga IKEA, sepse nuk do të qëndrojnë gjatë". "Kjo nuk vlen vetëm për ta, por edhe për zotin Gruevski, ish-kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, gjithashtu shkelës i ligjit", tha Magyar në një konferencë për gazetarë.

Ai shtoi se, në frymën e bashkëpunimit evropian, pret edhe nga vendet e tjera evropiane që t'i ekstradojnë kriminelët hungarezë nëse ata arratisen në territoret e tyre.

Se si dhe kur Qeveria e re hungareze do ta rregullojë këtë çështje, partia e Magyarit, Tisza, nuk iu përgjigj Radios Evropa e Lirë.

Në zgjedhjet parlamentare të 12 prillit Magyar e rrëzoi nga pushteti Viktor Orbanin, i cili qeverisi Hungarinë për 16 vjet. Orban, si kryeministër i Hungarisë, ishte në shënjestër të kritikave të ashpra nga Brukseli

për minimin e demokracisë dhe kundërshtimin e mbështetjes për Ukrainën, pas pushtimit rus.

Për shkak të shqetësimeve për gjendjen e demokracisë dhe sundimin e ligjit, BE-ja bllokoi miliarda euro nga fondet e destinuar për Hungarinë.

Gjatë qeverisjes së Orbanit, strehë në këtë vend gjeti edhe Gruevski. Ish-kryeministri maqedonas, në nëntor të vitit 2018, në vend që të fillonte vuajtjen e dënimit, u arratis nga Maqedonia e Veriut me një automjet diplomatik hungarez.

Disa ditë më vonë, ai mori azil politik në Hungari.

Autoritetet hungareze e arsyetuan këtë vendim me "ndjekjen e mundshme politike dhe gjendjen e keqe në burgjet maqedonase". Një vit më pas, një gjykatë hungareze refuzoi kërkesën e autoriteteve maqedonase për ekstradimin e tij, duke thënë se "nuk ishin përmbushur kushtet për ekstradim në Maqedoninë e Veriut".

Ministria e Drejtësisë e Maqedonisë së Veriut nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse planifikon të paraqesë kërkesë të re për ekstradimin e Gruevskit.

"Nëse vjen, do të arrestohet"

Nëse Gruevski hyn në Maqedoninë e Veriut ai do të arrestohet, tha kryeministri aktual i këtij vendi, Hristijan Mickoski. Ai shtoi se rasti i Gruevskit është në dorën e Qeverisë hungareze. "Nuk kam pritje, por nëse Nikolla Gruevski paraqitet në Maqedoni [të Veriut], ai ka një vendim të formës së prerë dhe, menjëherë pas hyrjes

në vend, organet e rendit do ta ndalojnë dhe do ta dërgojnë për vuajtjen e dënimit me burg, në përputhje me vendimin përfundimtar", tha Mickoski, njëherësh kryetar aktual i VMRO-DPMNE-së, ish-partisë së Gruevskit.

Ai theksoi se nuk ka asnjë pritje nëse dhe kur Gruevski do të kthehet në Maqedoninë e Veriut. "Ne, si Qeveri, kemi përpara një vendim përfundimtar, sipas të cilit personi për të cilin po flasim, duhet të vuajë dënim me burg", u shpreh Mickoski. "Organizata kriminale VMRO ka mbetur pa aleatin e saj të vetëm në BE", shkroi në platformën X lideri i opozitës nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), Venko Filipçe. "Nuk do të ketë më fshehje të Gruevskit në Budapest, as marrëveshje biznesi. Kryeministri i ri i Hungarisë, zoti Peter Magyar, ka paralajmëruar reforma të thella në media, për shkak të ndikimit të madh që kishte Orban mbi to. Regjimet autokratike po bien", shtoi ai.

Nga partia Tisza e Magyarit thanë se Qeveria e ardhshme hungareze do t'i japë përparësi rikthimit të sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit, anëtarësimit në Zyrën e Prokurorit Publik Evropian dhe vendosjes së një funksionimi të ri më transparent të shtetit.

Orban dhe Gruevski

Nikolla Gruevski ishte kryeministër i Maqedonisë së Veriut nga viti 2006 deri në vitin 2016 dhe lider i VMRO-DPMNE-së, parti e cila, pas shtatë vjetësh në opozitë, u rikthye në pushtet në zgjedhjet e vitit 2024.



Me kryeministrin në largim të Hungarisë, Viktor Orban, ai kishte një miqësi të gjatë politike, dhe Orban ishte shpesh i pranishëm në fushatat zgjedhore të VMRO-DPMNE-së.

Dy partitë e djathta, si parti simotra, ishin pjesë e Partisë Popullore Evropiane (EPP).

Megjithatë, partia e Orbanit u largua nga EPP-ja në mars të vitit 2021, pak para se të përjashtohet, pas kritikave të gjata nga BE-ja për minimin e lirive demokratike, mediave, organizatave joqeveritare dhe sundimit të ligjit. Si parti simotër, Fidesz e ka mbështetur rregullisht VMRO-DPMNE-në.

Në kohën kur Gruevski ishte kryeministër, Orban u nderua me një çmim shtetëror nga Maqedonia e Veriut - Urdhrin "8 Shtatori".

Si rodhi rasti Gruevski?

Në maj të vitit 2018, Gruevski u dënua me dy vjet burg në rastin "Tenk", për shkak të parregullsive në prokurimin e një automjeti të blinduar Mercedes, me vlerë

600.000 euro.

Për blerjen e automjetit luksoz u mësua në vitin 2015, kur opozita e atëhershme publikoi një bisedë të përgjuar, në të cilën Gruevski i kërkonte ministres së Brendshme, Gordana Jankuloska, që MPB-ja të blejë një Mercedes që ai më pas ta përdorte, por pa dijeninë e publikut.

Atëkohë, Gruevski ishte kryeministër i Maqedonisë së Veriut.

Përveç këtij rasti, ndaj tij u zhvilluan edhe disa procese të tjera gjyqësore.

Në shtator të vitit 2020, ai u dënua në mungesë me një vit e gjysmë burg për dhunë ndaj kundërshtarëve politikë.

Në prill të vitit 2022, për rastin "Parcelat në Vodno", u dënua në shkallë të parë me shtatë vjet burg për pastrim parash, përfitim të paligjshëm dhe fshehje të pasurisë.

Po në të njëjtin muaj, Departamenti i Thesarit i SHBA-së e vendosi atë në listën e sanksioneve për korrupsion. Në listë u përfshi edhe kompania e tij në Hungari, I.C.I.C. KFT.

KËRKOHET PEZULLIMI I PROCESIT PËR BORDIN E KPM-së DHE TË RTK-së

PRISHTINË, 15 PRILL - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe organizata të shoqërisë civile kanë kërkuar që të pezullohet procesi i zgjedhjes së anëtarëve të bordit të Komisionit të Pavarur për Media dhe të Radio Televizionit të Kosovës, duke e akuzuar Lëvizjen Vetëvendosje në pushtet se po tenton “të kapë” këto dy borde të pavarura.

Në një konferencë për medie para Kuvendit të Kosovës, kreu i AGK-së, Xhemajl Rexha, shprehu shqetësim për procesin që po vazhdon. “AGK dhe shoqëria civile kërkon që ky proces të pezullohet si i tillë për momentin dhe të rinisë kur të sigurohet që do të ketë një proces fer, transparent dhe me kohë të përshtatshme për përgatitje, si të deputetëve për t’i marrë në pyetje ata që duan të bëhen pjesë e këtyre dy bordeve, gjithashtu edhe e atyre që kanë garuar për të qenë pjesë e tyre”, tha ai. Sipas Rexhës, LV-ja e kryeministrit Albin Kurti po synon që ta përfundojë këtë proces javën e ardhshme, para 28 prillit, para një shpërndarjeje të mundshme të Kuvendit.

Një ditë më parë Komisioni ad hoc për KPM-në vendosi që ta shtyjë procesin përpara dhe, sipas Rexhës, bëhet fjalë për mbi 70 kandidatë që kanë garuar për bordin e RTK-së dhe mbi 30 për KPM-në që, sipas tij, nuk u është dhënë koha e duhur që të përgatiten për

intervista.

Ndërkaq, komisioni për bordin e RTK-së dështoi në mungesë kuorumi. “RTK-ja dhe KPM-ja në syrin e AGK-së dhe komunitetit të gazetarëve janë kruciale për lirinë e medias në Kosovë dhe ne dëshirojmë që më të mirë të ketë vonesë për përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve sesa të ketë një proces, që tashmë është i kompromentuar, dhe që ka për synim, e shohim, një kapje politike të këtyre bordeve nga Lëvizja Vetëvendosje”, tha Rexha.

AGK shprehu shqetësim për kohën e kufizuar në 15 minuta për përgjigjen në pyetje të kandidatëve për KPM-në, për kohën e shkurtër të deputetëve për të shqyrtuar dosjen e kandidatëve, pasi tha se dosjet u janë dorëzuar të premtën e kaluar.

Sipas Ligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës, Bordi i RTK-së ka 11 anëtarë, ndërkaq ai i KPM-së shtatë.

Mexhide Demolli nga Lëvizja FOL, që ka monitoruar procesin, paraqiti disa nga mangësitë e procesit, që e vlerësoi të kompromentuar. Sipas saj, është vendosur që të gjithë kandidatët të përjashtohen nga gara nëse nuk kanë plotësuar dokumentacionin dhe pasi u është dhënë mundësia për t’i plotësuar, disave edhe pse nuk kanë pasur as dokumentet bazike, sikurse CV-ja, u është



mundësuar të kalojnë tutje. “Në këto raste komisioni ka ndryshuar metodologjinë pa asnjë arsytim duke favorizuar në mënyrë të hapur disa kandidatë dhe një nga ta është përjashtuar në mënyrë të kundërligjshme”, tha Demolli. Duke folur për procesin e intervistimit, që zhvillohet sot dhe nesër, Demolli tha se praktikën e deritanishme kanë qenë që deputetët kanë përzgjedhur pyetje dhe për të gjithë kandidatët kanë qenë njësojë. Por, tani kjo ka ndryshuar dhe administrata e komisionit është udhëzuar që të përgatisë 20-30 pyetje nga të cilat secili kandidat zgjedh tri, duke shtuar se edhe deputetët mund të bëjnë pyetje shtesë, gjë që nuk ka qenë në të kaluarën. Përzgjedhja e pyetjeve nga kandidatët, sipas Demollit, bën që ata të mos

trajtohen në mënyrë të barabartë. “Po ashtu, komisioni ka paraparë vetëm dy ditë për intervistim të 75 kandidatëve, pra 37 kandidatë në ditë dhe vetëm 15 minuta do të kenë kohë që të përgjigjen në intervistë”, tha ajo, duke argumentuar se kjo është kohë e pamjaftueshme. Ndërkaq këshilltarja ligjore në Qendrën Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, Flutura Kusari, paraqiti ato që i cilësoi si karakteristika që mbështesin idenë se pushteti po synon “të kapë institucione të pavarura”. Ajo argumentoi se kualiteti i kandidatëve është i ulët pasi, sipas Kusarit, profesionistët “nuk besojnë” se LV-ja mund të zhvillojë një proces fer, transparent dhe të bazuar në merita. “Pastaj kemi standarde të shumëfishta. Një kandidat favorizohet sepse qartazi,

publikisht dihet që është pro LV-së dhe dikush tjetër përjashtohet sepse dihet publikisht që anon nga opozita, ndonëse një gjë e tillë është e kundërligjshme”, tha Kusari.

Ajo pretendoi se disa deputetë të LV-së madje janë takuar nëpër kafene me kandidatë për këto borde, duke e cilësuar “të papranueshme”.

Kusari tha se nuk mund t’i ndalin këto veprime, por “ne jemi këtu për ta dokumentuar këtë kapje dhe për të ftuar LV-në që të reflektojë edhe njëherë dhe t’i pezullojë këto procese sepse Kosova ka qenë kampione e lirisë së mediave në rajon, e ne e kemi humbur këtë titull”, tha ajo. Edhe për Gëzim Shalën nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, ndërhyrjet në institucionet e pavarura që rregullojnë lirinë e medias në Kosovë kanë ndikuar në rënien e lirisë së medias në Kosovë. “KPM, si komisioni i pavarur dhe si rregullator i mediave, ka një rëndësi kruciale në fushën e lirisë së shprehjes dhe rolit të mediave në Kosovë. Së bashku me bordin e RTK-së janë si bazamente të demokracisë”, tha ai.

Vitet e fundit në indeksat për lirinë e medias Kosova ka pësuar rënie. Në indeksin e Reporterëve pa Kufij më 2025 Kosova shënoi rënien më të madhe në 15 vjetët e fundit për lirinë e shtypit. Ky është viti i dytë radhazi që Kosova shënon rënie, pasi në vitin 2024 ra nga vendi i 56 në të 75-tin.

PETRIT AJETIT I VAZHDOHET MANDATI EDHE PËR PESË VJET SHEF I AKI-së

PRISHTINË, 15 PRILL - Petrit Ajeti do të jetë në krye të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI) edhe pesë vjet të tjera, pasi iu vazhdua mandati të martën.

Presidenca e Kosovës njoftoi në uebsajtin e vet se ushtruesja e detyrës e presidentes së vendit, Albulena Haxhiu, dhe kryeministri Albin Kurti, e nënshkruan të martën vendimin për vazhdimin e mandatit të Ajetit drejtor i AKI-së për një mandat të ri pesëvjeçar. “Ky vendim pasqyron vlerësimin institucional për profesionalizmin, përkushtimin dhe punën e deritanishme të z. Ajeti në udhëheqjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, si dhe besimin në vazhdimësinë e liderit të tij në forcimin e kapaciteteve të inteligjencës dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, thuhet në njoftim.

Ajeti u emërua shef i AKI-së për herë të parë në vitin 2021 dhe është vetëm drejtori i dytë pas Bashkim Smakajt që e përfundon një mandat të plotë



në këtë detyrë në historinë e AKI-së.

Ajeti kreu Shkencat Politike në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, ndërsa në vitin 2001 kreu studimet në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” në Tiranë.

Ai mbaroi studimet e nivelit

Master në fushën e Arteve në Përgjegjësinë Sociale të Korporatave në Universitetin Metropolitan të Londrës në Mbretërinë e Bashkuar. Ai ka kryer edhe disa programe të zhvillimit profesional në Gjermani dhe ShBA.

Në vitet para ardhjes së Ajetit,

AKI-ja kishte ndërruar tre drejtorë. I vetmi që deri atëherë kishte përfunduar një mandat të plotë ishte drejtori i parë, Bashkim Smakaj, i cili ishte emëruar në këtë post në shkurt të vitit 2009.

Një vit pas riemërimit, më 2015, ai kishte dhënë dorëheqje, duke

u zëvendësuar nga Agron Selimaj. Ky i fundit, po ashtu, kishte dhënë dorëheqje dy vjet më vonë, më 2017. Në vend të tij, më 2017, u emërua Driton Gashi, të cilit iu kërkuar ta lironte detyrën vetëm një vit pas marrjes së detyrës për shkak të skandalit me arrestimin dhe dëbimin e gjashtë shtetasve turq. Pas tij në pozitën e drejtorit të AKI-së ishte emëruar Kreshnik Gashi, të cilit, po ashtu, iu kërkuar largimi nga ky post në dhjetor të vitit 2020.

Në bazë të ligjit në fuqi, drejtori i AKI-së i përgjigjet drejtpërdrejt kryeministrit.

Po sipas këtij ligji, drejtori i AKI-së shërben këshilltar i presidentit dhe kryeministrit për çështje të inteligjencës që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës; njofton presidentin dhe kryeministrin për aktivitetet e AKI-së dhe ofron informata për presidentin dhe kryeministrin sa i takon sigurisë.



KONJUFCA PËR ÇËSHTJEN E PRESIDENTIT: SHKOJMË NË ZGJEDHJE NËSE KY ËSHTË VULLNETI I OPOZITËS

Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Glauk Konjufca, tha se çështja e zgjedhjes së presidentit të ri të vendit varet nga vullneti i partive opozitare. “Shkojmë në zgjedhje të reja nëse ky është vullneti i opozitës. Nuk kemi çfarë të bëjmë”, tha ai për mediet të mërkurën. Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se është në kontakt me krerët e partive opozitare, e “kur ka rezultate atëherë ju njoftojmë”

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 PRILL - Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës i Kosovës, Glauk Konjufca, tha se çështja e zgjedhjes së presidentit të ri të vendit varet nga vullneti i partive opozitare. “Shkojmë në zgjedhje të reja nëse ky është vullneti i opozitës. Nuk kemi çfarë të bëjmë”, tha ai për mediat më 15 prill. Duke folur për propozimet që mund të bëjë subjekti më i madh opozitar, Partia Demokratike e Kosovës, Konjufca tha se në këtë parti ka “emra të pakapërcyeshëm” për LV-në dhe nëse këta emra propozohen, sipas tij, më pas ky subjekt opozitar do ta fajësonte partinë në pushtet për dështim të zgjedhjes së presidentit.

Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha shkurt për mediet se është në kontakt me krerët e partive opozitare, e “kur ka rezultate atëherë ju njoftojmë”. Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë afat deri më 28 prill që ta zgjedhin presidentin, në të kundërtën vendi do të shkojë në zgjedhje. Kreu i LV-së, njëherësh kryeministër i Kosovës, Albin Kurti, ditë më parë ka zhvilluar takim me Lumir Abdixhikun, kryetarin e subjektit opozitar Lidhja Demokratike e Kosovës, por takimi ka përfunduar pa ndonjë marrëveshje për presidentin. LV-ja më herët ka paralajmëruar edhe takime të tjera me LDK-në dhe PDK-në. Nënkryetarja e Kuvendit nga radhët e PDK-së, Vlora Çitaku, ka folur një ditë më parë pas

mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, duke komentuar çështjen e zgjedhjes së presidentit. Ajo theksoi se përgjegjësia kryesore bie mbi shumicën parlamentare, duke shtuar se ajo ka alternativa dhe nuk është e detyruar të negociojë vetëm me PDK-në. “Parlamenti i Kosovës i ka 120 deputetë, PDK-ja i ka vetëm 22 deputetë. Shumica parlamentare, nëse është e interesuar për ta zgjedhur presidentin, nuk e ka opsion të vetëm bisedimin dhe dakordimin me PDK-në, ka edhe opsione të tjera”, tha Çitaku. Ajo e cilësoi zgjedhjen e presidentit si një moment i rëndësishëm për demokracinë parlamentare, duke kërkuar qasje më serioze nga qeveria. “Zgjedhja e presidentit është moment i rëndësishëm për një demokraci parlamentare dhe kjo duhet të trajtohet me seriozitetin që i takon”, u shpreh ajo. Çitaku bëri me dije se PDK ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti t'i formalizojë kërkesat ndaj këtij subjekti politik. “Kemi kërkuar nga z. Kurti që ta formalizojë kërkesën e tij karshi PDK-së me një letër të shkruar. Deri në këtë moment, një letër e tillë nuk ka ardhur në adresë të

PDK-së”, tha Çitaku. Njohësi i çështjeve politike, Burim Ramadani, ka vlerësuar se Kosovës i duhet një president i ri dhe jo zgjedhje të reja parlamentare. Ai tha se arritja e konsensusit për zgjedhjen e presidentit nuk duhet se është afër. “Na duhet të kemi president, nuk na duhen zgjedhje! Kjo do duhej të ishte fjalia udhëheqëse për partitë politike në këtë situatë. Sikur ky të ishte qëllimi, atëherë një manual veprimesh do të ndërtohej shumë lehtë dhe shumë thjesht. Deri më tash as kjo fjali nuk ekziston dhe as ky manual nuk është formësuar. Askush askujt nuk i beson sot në politikën kosovare. Pothuajse secili e secila është pëshqjelluar në taktika elektorale e personale dhe kanë kontribuar për të thelluar mosbesimin e gjithanshëm. Rrjedhimisht, një situatë e tillë e dërgon Kosovë sërish në zgjedhje parlamentare dhe kjo është në kundërshtim me interesin kombëtar dhe vullnetin qytetar. Arritja e konsensusit për zgjedhjen e presidentit nuk duhet se është afër”, ka thënë ai në një intervistë për “Epokën e re”. Që nga 4 prilli kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, ka marrë postin e ushtrueses së detyrës së presidentit, pasi ish-

presidentes Vjosa Osmani i skadoi mandati pesëvjeçar. LV-ja e Kurtit më 5 mars propozoi dy emra për pozitën e presidentit: Glauk Konjufcën, ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe deputeten Fatmire Mullhaxha-Kollçaku. Në mungesë kuorumi, procesi ka mbetur në gjysmë. Të nesërmen ish-presidentja Vjosa Osmani paraqiti një dekret për shpërndarje të Kuvendit dhe hapje të rrugës për zgjedhje të reja. Vetë Osmani e synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo nuk e siguroi mbështetjen e nevojshme në këtë drejtim. Dekreti u dërgua në Gjykatën Kushtetuese nga qeveria. Gjykata më pas doli me vendim duke thënë se dekreti i ish-presidentes nuk ka pasur asnjë efekt juridik dhe e përcaktoi 28 prillin si afat i fundit për zgjedhje të presidentit, në të kundërtën shteti shkon në zgjedhje që duhen të mbahen brenda 45 ditësh. Lëvizja Vetëvendosje i ka fituar bindshëm zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit të vitit 2025 dhe gëzon 57 ulëse në Kuvend, por ato janë të pamjaftueshme për zgjedhjen e presidentit, meqë për ta finalizuar këtë proces nevojiten të paktën 80 vota në Kuvendin me 120 deputetë.

JOSEPH: KURTI TË HEQË DORË NGA POPULLIZMI PËRÇARËS DHE TË PËRFITJË NGA DOBËSIMI I VUÇIQIT



PRISHTINË, 15 PRILL - Humbja e Viktor Orbanit në zgjedhjet në Hungari krijon një dritare të re mundësie për Kosovën, vlerëson Edward P. Joseph, ligjërues në Universitetin "Johns Hopkins" në ShBA dhe ekspert i menaxhimit të konflikteve. Ai e përshkruan largimin e liderit hungarez pas 16 vjetësh në pushtet si një "goditje" për presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, duke theksuar se ai ka qenë një faktor kyç që i ka dhënë Beogradit hapësirë manovrimi brenda BE-së. Sipas tij, kryeministri i

Kosovës, Albin Kurti, duhet ta shfrytëzojë këtë "dobësim të Vuçiqit", të tregojë përgjegjësi shtetërore dhe ta pozicionojë Kosovën si faktor stabiliteti, duke i lënë pas qasjet përçarëse. "Ashtu siç administrata Trump nuk është e interesuar për lojërat e Vuçiqit, ajo nuk është e interesuar as për ato të Kurtit. Pezullimi i Dialogut Strategjik shtatorin e kaluar ishte dëshmi për këtë", thotë Joseph për Radion Evropa e Lirë.

Joseph flet edhe për përplasjet mes ShBA-së dhe Evropës dhe

ndikimin e tyre të mundshëm në Kosovë, në kohën kur në BE po shtohen thirrjet për më shumë autonomi në fushën e mbrojtjes.

Megjithatë, sipas ekspertit amerikan, roli i Shteteve të Bashkuara mbetet vendimtar - si boshti kryesor i NATO-s dhe garantuesi kryesor i sigurisë në Ballkan. Ai ka thënë se prioriteti strategjik i Kosovës duhet të jetë pikërisht shfrytëzimi i vështirësive të Vuçiqit për t'u shfaqur si një shtyllë stabiliteti dhe bashkëpunimi në Ballkan. "Pas takimeve të

tij në Paris dhe Londër, tani është momenti për kryeministrin Albin Kurti që ta stabilizojë situatën në Kosovë. Kurti duhet të tregojë përgjegjësi shtetërore dhe të bashkëpunojë me opozitën për një zgjidhje kompromisi për presidentin. Kurti, gjithashtu, duhet të ndërmarrë hapa të veçantë për të treguar përkushtimin e tij të fortë ndaj komuniteteve joshumicë. Ai duhet t'i vizittojë serbët dhe të deklarojë angazhimin e tij të plotë, se shërbimet shëndetësore dhe shërbimet e

tjera do të vazhdojnë pa ndërprerje, derisa institucionet dikur serbe të integrohen në Republikën e Kosovës. Ndërsa Vuçiq përballlet me një vëmendje gjithnjë e më të madhe nga BE-ja - ku ai nuk e gëzon më mbrojtjen e Viktor Orbanit - Kurti mund ta shfrytëzojë këtë situatë. Tani është momenti për të vendosur interesat e Kosovës në plan të parë dhe për të treguar kapacitete shtetërore si brenda vendit, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare", ka thënë Joseph.

Hartohet Strategjia e Rinisë së kryeqytetit 2026 - 2034

PRISHTINË, 15 PRILL - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se është hartuar Strategjia e Rinisë 2026-2034, e shoqëruar me plan veprimi katërvjeçar.

Rama në "Facebook" ka shkruar se kjo strategji është ndërtuar mbi pesë shtylla kryesore. Sipas tij, strategjia përfshin indikatorë të matshëm dhe buxhet të planifikuar, në përputhje me objektivat ndërkombëtare.

"Është hartuar Strategjia e Rinisë 2026-2034, e shoqëruar me plan veprimi 4-vjeçar, e ndërtuar mbi 5 shtylla kryesore: Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje; Fuqizimi ekonomik dhe ndërmarrësia; Edukimi joformal dhe inovacioni; Hapësirat dhe qendrat rinore; Mirëqenia, shëndeti mendor dhe vullnetarizmi. Strategjia përfshin indikatorë të matshëm dhe buxhet të

planifikuar, në përputhje me objektivat ndërkombëtare. Po ashtu, për rreth 8 vite kanë qenë jofunksionale Këshilli Lokal Rinor dhe qendrat rinore. Hapat e radhës: Riaktivizimi i Këshillit Lokal Rinor; Krijimi i platformës digjitale 'Prishtina Youth' për angazhimin e të rinjve. Të rinjtë janë potenciali më i madh i qytetit tonë është koha t'u japim hapësirën dhe mbështetjen që meritojnë", ka shkruar Rama.



Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi për praktikantë me pagesë në komunën e Rahovecit

RAHOVEC, 15 PRILL - Komuna e Rahovecit dhe Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren kanë formalizuar një marrëveshje bashkëpunimi përmes së cilës

do të angazhohen tre praktikantë me pagesë në administratën komunale. Përmes këtij bashkëpunimi studentëve u ofrohet mundësia

të fitojnë përvojë praktike dhe t'i zhvillojnë aftësitë profesionale, duke u përgatitur më mirë për tregun e punës. "Ky hap dëshmon

përkushtimin e institucioneve për ta mbështetur zhvillimin profesional të gjeneratave të reja", ka njoftuar komuna e Rahovecit.



SHËNOHET 'EPOPEJA E UÇK-së, BETEJA E ZHEGOCIT'

GJILAN, 15 PRILL - Me rastin e shënimit të 27-vjetorit të "Epopesë së UÇK-së, Beteja e Zhegocit", organizuar në përkujdesjen e kryetarit të komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, respektivisht Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me shoqatat e

dala nga lufta e UÇK-së, janë bërë të mërkurën homazhe te Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve në Gjilan, ndërsa ora e parë e mësimit në të gjitha shkollat e komunës së Gjilanit i është kushtuar "Epopesë së UÇK-së - Beteja e Zhegocit".



FSK-ja PO REALIZON GARËN NDËRKOMBËTARE "USHTARI MË I MIRË 2026"

FERIZAJ, 15 PRILL - Forca e Sigurisë së Kosovës po realizon "Garën e ushtarit më të mirë 2026". Ekipet ushtarake nga vendet e NATO-s dhe shteteve partnere: Ajova-ShBA, Corps V- ShBA, Italia, Kosova, Kroacia, Maqedonia e

Veriut, Mbretëria e Bashkuar, Shqipëria, janë bërë bashkë në Kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, ku po realizohet gara ndërkombëtare duke sfiduar pjesëmarrësit në shkathësitë fizike dhe ushtarake.

KURTI: SOT 11 410 BIZNESE JANË AKTIVE NË SEKTORIN E EKONOMISË DIGJITALE DHE TË SHËRBIMEVE PROFESIONALE

PRISHTINË, 15 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë të mërkurën në tryezën e organizuar nga ABSL Kosovo, me temën "Kosova: Nga një destinacion pranë bregut në një kufi inovacioni".

Në fjalën hyrëse ai tha se sektorët e shërbimeve BPO dhe TIK janë ndër sektorët që po rriten më së shpejti në ekonominë tonë dhe sot ata punësojnë drejtpërdrejt mbi 47 000 persona. "Qeveria e Kosovës e ka bërë zhvillimin e këtij sektori një prioritet të qartë për veten e saj në strategji e në zbatim. Strategjia e Punësimit 2024-2028 vendos



sektorin e TIK-ut dhe shërbimeve BPO në qendër të krijimit të vendeve të punës për

të rinjtë. Ne po i rishikojmë kurrikulat arsimore në bashkëpunim me industrinë,

po krijojmë stimuj fiskalë për investitorët e rinj dhe po punojmë për t'i thjeshtuar procedurat administrative", tha kryeministri Kurti.

Ai ka thënë se sot 11 410 biznese janë aktive në sektorin e ekonomisë digjitale dhe të shërbimeve profesionale e mbështetëse, me një qarkullim i cili ka arritur në 2 miliardë euro në vitin që lamë pas, "duke shënuar një rritje mesatare vjetore prej 16 për qind". Nga këto, 78 për qind sigurojnë të ardhura nga tregjet ndërkombëtare, kryesisht nga Gjermania, Zvicra dhe Austria. Kjo tregon se Kosova, përtej produkteve, eksporton aftësi

dhe njohuri", ka thënë Kurti, duke shtuar se nëse pyetet se cila është pasuria më e madhe e Kosovës, ai ka thënë se "do të them njerëzit tanë". "Jemi populli më i ri në Evropë me më shumë se gjysmën e popullsisë nën moshën 35 vjeçare, të cilët flasin disa gjuhë, janë të talentuar e optimistë dhe kanë shkollimin për ta zhvilluar talentin e tyre. Sipas raportit të Emerging Europe, Kosova ka numrin më të madh të studentëve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për kokë banori, në 23 shtetet evropiane të cilat i mbulon ky raport", ka deklaruar Kurti.

Në shkurt më pak vdekje se në janar, ASK-ja publikon statistikave

PRISHTINË, 15 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës ka paraqitur të dhëna lidhur me numrin e vdekjeve në Kosovë.

Sipas statistikave të ASK-së, gjatë muajit shkurt 2026 janë regjistruar gjithsej 901 raste të vdekjeve (brenda dhe jashtë

Kosovës). Nga gjithsej vdekje të regjistruara, 463 janë meshkuj dhe 438 janë femra. Krahasuar me muajin janar

2026, në muajin shkurt 2026 janë regjistruar (21,2 %) raste të vdekjeve të ndodhura më pak.



ABDIXHIKU ZGJEDH KRYESINË E RE TË LDK-SË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 PRILL - Në përputhje me autorizimet e marra nga Kuvendi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i mbajtur më 31 janar, me të cilat autorizime kërkohet vendosja e Kryesisë së re si pjesë e riorganizimit të thellë politik, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, pas konsultimeve të brendshme, ka marrë vendim për emërimin e Kryesisë së re të LDK-së në përputhje me këto autorizime të organit më të lartë vendimmarrës të partisë. Sipas komunikatës së LDK-së, kjo përbërje reflekton përvojën institucionale, energjinë e re, mbi të gjitha përbashkimin e të gjitha niveleve si element thelbësor i forcimit partiak. "Kryesia e re është në funksion të forcimit të organizimit të brendshëm, përfaqësimit të strukturave dhe rritjes së efikasitetit në vendimmarrje. Kryesia e re do të ketë përgjegjësi të plotë për drejtimin politik dhe organizativ të partisë, në përputhje me programin tonë dhe objektivat përpara. Kjo përbërje vjen edhe si rezultat i një faze të ndërmjetme organizative, në zbatim të platformës së miratuar nga Kuvendi, e cila parashihet konsolidimin e strukturave dhe fuqizimin e



lidhjes ndërmjet qendrës dhe degëve", është thënë në komunikatën e LDK-së, duke shtuar se në këtë periudhë kalimtare, Kryesia e LDK-së ndërtohet me përfaqësim më të drejtpërdrejtë të drejtuesve të degëve, si bartës të legjitimitetit nga baza, ndërsa standardet e reja organizative do të zbatohen plotësisht në ciklin e ardhshëm të ristrukturimit. "Në ditët në

vijim, pas konsultimeve shtesë, Kryesia do të plotësohet me përfaqësues nga degët e mëdha të papërfaqësuar në këtë përbërje. Në këtë fazë të rëndësishme politike, LDK-ja mbetet e përkushtuar ndaj forcimit të brendshëm, përfaqësimit të gjerë dhe ndërtimit të një alternative serioze për qytetarët e Republikës. Kryetari i LDK-së,

në përputhje me udhëzimet dhe autorizimet e marra, do të propozojë së shpejti dhe Trupën Këshillëdhënëse, të përbërë nga figura të shquara të Lidhjes Demokratike të Kosovës, me përvojë të jashtëzakonshme institucionale e profesionale; si pjesë e riorganizimit të brendshëm", është theksuar në komunikatën e LDK-së.

KRYESIA E RE E LDK-SË:

Kryetar:

Lumir Abdixhiku

Anëtarët e Kryesisë (sipas renditjes alfabetike):

Alban Zogaj
Alush Gashi
Anton Quni
Arbër Ismajli
Ardian Shala
Arjeta Salihu Abazi
Armend Zemaj
Avdullah Hoti
Berat Rukiqi
Besian Mustafa
Bexhet Xheladini
Doarsa Kica Xhelili
Doruntinë Maloku
Ekrem Hyseni
Ermal Sadiku
Fadil Hadergjonaj
Festim Kabashi
Gazmend Muhaxheri
Hykmete Bajrami
Ilir Ferati
Izet Sadiku
Jehona Lushaku Sadriu
Kujtim Shala
Lutfi Haziri
Paris Guri
Ruzhdi Shehu
Shefqet Shehu
Shkëmb Manaj
Sibel Halimi
Sokol Haliti
Sokol Havolli
Ukë Rugova
Visar Azemi
Xhafer Gashi

PROKURORIA KËRKON BURGIM TË PËRJETSHËM PËR TË AKUZUARIT NË RASTIN "BANJSKA"

PRISHTINË, 15 PRILL - Prokuroria Speciale e Kosovës ka kërkuar burgim të përjetshëm për tre të akuzuarit për rastin "Banjska" gjatë fjalës përfundimtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë më 15 prill. "Dënimi i vetëm proporcional është burgimi i përjetshëm", tha prokurori special Naim Abazi. Teksa gjykimi po shkon drejt fundit, sipas prokurorit Abazi, çdo vendim tjetër, përpos burgimit të përjetshëm, nuk do të ishte në përputhje me gravitetin e veprës. Në Gjykatën Themelore në Prishtinë po gjykohej Vladimir Tolliq, Bllagoje Spasojeviq dhe Dushan Maksimoviq. Ata janë vetëm tre persona nga 45 personat e përfshirë në aktakuzën për sulmin në Banjskë, që Kosova e cilëson si terrorist dhe e fajëson Serbinë për të. Një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës më 24 shtator 2023, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Gjatë këmbimit të zjarrit u vranë edhe tre sulmues serbë. "Këto veprime, të 24 shtatorit 2023, përbejnë akte të mirëfillta terroriste duke shkaktuar vrasje dhe lëndime të zyrtarëve policorë, përdorim të eksplozivëve dhe armëve të

rënda si dhe rrezikim serioz të njerëzve me synim destabilizimin dhe cenimin e strukturave themelore politike, kushtetuese, ekonomike dhe shoqërore të Kosovës", tha ai. Prokurori special në fjalën e tij tha se synimi i grupit të serbëve të armatosur që, sipas Abazit, u stërvitën paraprakisht në Rashkë të Serbisë, ishte që veriu i Kosovës i banuar me shumicë serbe të shpëtohet nga Kosova dhe të bashkohen me Serbinë. Gjatë seancës edhe avokati i familjes të rreshterit të ndjerë, Bunjaku, kërkoi burgim të përjetshëm për tre të akuzuarit. Tre të akuzuarit i kanë mohuar akuzat dhe kanë pretenduar se nuk kishin qëllim vrasjen e askujt, aq më pak bashkimin e veriut të Kosovës me Serbinë, ashtu siç thotë aktakuza. Përgjegjësini për sulmin e armatosur në Banjskë e ka marrë Millan Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - që gëzon përkrahjen e Beogradit zyrtar. Beogradit, ndërkaq, ka mohuar se qëndron prapa sulmit. Për Radoiçiqin dhe 41 të akuzuarit e tjerë të këtij rasti, që ndodhen në arrati, prokurorët kishin kërkuar gjykim në mungesë, por Gjykata



Themelore e hodhi poshtë kërkesën e tyre si të "pabazuar". Dyzet e dy të dyshuarit akuzohen për terrorizëm, vepra të rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës, ndërsa Radoiçiq akuzohet edhe për lehtësim dhe financim në kryerjen e terrorizmit, si dhe për shpëlarje parash.

Çfarë përmban aktakuza?

Në shtator të vitit 2024 - një vit pas sulmit - Prokuroria Speciale ngriti aktakuzë për ngjarjet në Banjskë. Aktakuza, veç të

tjerash, i ngarkon të akuzuarit në rastin Banjska me vepra terroriste dhe vepra kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës. Më herët prokurori Abazi ka thënë se të akuzuarit kanë pasur role të ndryshme brenda grupit kriminal, "nga organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve terroriste, deri te financimi dhe pastrimi i parave". Në aktakuzë thuhet se ky grup, përmes përdorimit të dhunës me armatim të rëndë, ka tentuar "ta shpëtojë pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës, respektivisht komunat e banuara me shumicë serbe, dhe

këtë pjesë të territorit t'ia bashkojë Republikës së Serbisë".

Si lider i këtij grupi është identifikuar Millan Radoiçiq, për të cilin thuhet se ka luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin e sulmit dhe aktivitetet kriminale.

Radoiçiq gjendet në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar për lidhjet me krimin e organizuar ndërkombëtar dhe korrupsionin. Në Kosovë, ai, gjithashtu, lidhet me vrasjen e një politikani opozitar serb, si dhe me frikësimin e dëshmitarëve në një proces gjyqësor për disa ndërtime ilegale.

Në aktakuzë Prokuroria përmend 34 dosje me prova, në mesin e të cilave ka video-incizime, analiza të pajisjeve elektronike, përgjigje të ndryshme nga Luksemburgu, Bosnje e Hercegovina, bankat dhe institucione të ndryshme, deklarata të dëshmitarëve etj. Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar ashpër sulmin në Banjskë dhe ka kërkuar që përgjegjësit të dalin para drejtësisë. Ndërkaq, në shkurt të këtij viti, shefi i NATO-s, Mark Rutte, tha se aleanca ende po pret që Serbia ta përcaktojë përgjegjësinë për Banjskën.

Konfirmohet rasti i parë i sëmundjes Lija e Deleve/Dhive (Sheep Pox/GoatPox) në Kosovë

PRISHTINË, 15 PRILL - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përmes Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) njofton opinionin publik se është konfirmuar rasti i parë i sëmundjes Lija e Deleve/Dhive (Sheep Pox/GoatPox), në fshatin Sazli, komuna e Ferizajt. Pas hulumtimeve diagnostike në terren dhe zbatimit të

masave për kontrollin e sëmundjes, në mostrat e testuar në Laboratorin e Ushqimit dhe Veterinarisë është konfirmuar rasti i parë i sëmundjes Lija e Dhenve në një fermë të deleve në këtë fshat.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me datë 15.04.2026 ka vendosur masat e përgjithshme për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e

sëmundjes Lija e Deleve/Dhive (Sheep Pox/GoatPox) në Kosovë, Bazuar në Ligjin nr. 2004/21 për Veterinarinë. "Thërrasim për vëmendje Komunitet të brezit kufitarë me Shqipërinë, përmes drejtorive të për Bujqësi të vendosin masa strikte kufizuese të lëvizjes së bagëtive të imta në kullosat e brezit kufitarë. Fermerët mbajtëse të deleve

dhe dhive të mbajnë nën mbikëqyrje tufat e tyre, të shmangin çfarëdo kontakti me kopetë e fermerëve nga Shqipëria", thuhet në një njoftim të AUV-it.

Në njoftim theksohet se autoritetet kufitare do t'i forcojnë kontrollet në të gjitha pikat kufitare dhe zonat e brezit kufitar me Shqipërinë, me qëllim parandalimin e futjes së



sëmundjes në territorin e Republikës së Kosovës.

HOTI: PROJEKTLIGJI PËR ÇMIMET TAVAN ËSHTË I PAPËRMIRËSUESHËM PËRMES AMENDAMENTEVE

PRISHTINË, 15 PRILL - Ish-kryeministri dhe deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se projektligji për çmimet tavan, i cili kaloi në lexim të parë me procedura të shkurtuara, është i papërmirësueshëm. Sipas tij, masat e parapara në këtë projektligj nuk do ta mbrojnë konsumatorin. "Sot, me shumë kujdes e analizuam këtë projektligj për të parë nëse mund të propozohen amendamente për të evituar çrregullimet në treg që pritet të sjellë ky projektligj nëse hyn në fuqi në formatin aktual të propozuar nga Qeveria. Vlerësimi i përgjithshëm është se asnjë amendament nuk mund ta sjellë këtë projektligj në linjë me kërkesat dhe parimet për funksionimin e tregut të lirë në kohë të krizave dhe inflacionit, sikurse që po kalojmë tani. Masat e parapara

në këtë projektligj nuk do ta mbrojnë konsumatorin. Ato masa do ta dëmtojnë biznesin dhe nuk sigurojnë arritjen e qëllimit për të cilin ndërmerren. Nuk e kuptoj përse nuk organizohen debate publike me oda ekonomike dhe me organizata të tjera për të marrë vlerësimet e tyre. Nuk e kuptoj përse Qeveria nuk e sqaron publikisht si do të arrihet qëllimi i këtij ligji, që është mbrojtja e konsumatorit, përmes masave të parapara në këtë projektligj", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Ai ka thënë se logjika ekonomike në situata të tilla kërkon që ndërhyrjet të jenë në të dyja anët e tregut, në anën e kërkesës dhe të ofertës. "Në anën e kërkesës duhet ndërmerren masa për të ruajtur grupet më të ndjeshme të qytetarëve, si: punëtorët që marrin pagën minimale,



pensionistët, studentët, familjen në asistencë sociale dhe grupe të tjera të ngjashme. Mbështetja e këtyre grupeve nga buxheti i shtetit mund të jetë e njëjshme nëse kriza

është e përkohshme dhe nëse çmimet stabilizohen shpejt. Nëse kriza vazhdon, atëherë mbështetja duhet të jetë e përhershme duke i indeksuar të ardhurat e këtyre grupeve

për normën e inflacionit të produkteve të konsumit elementar", ka pohuar ai, duke theksuar se në anën e ofertës duhet të intervenohet në uljen e kostos për bizneset për ofrimin e mallrave në treg. "Në këtë aspekt, masë e menjëhershme është ulja e ngarkesave tatimore, siç janë TVSH dhe akciza. Duke qenë se të hyrat buxhetore rriten në kohë inflacioni për shkak të TVSH-së më të lartë në që mbledh shteti, është e natyrshme që ulja e normës së TVSH të ketë efekt minimal ose zero në të hyrat buxhetore. Prandaj, mungesa e masave të tilla nga ana e Qeverisë së Kosovës është e pakuptueshme se kujt i shërben. Disa nga këto masa janë ndërmarrë nga vendet evropiane. Shembulli më i fundit ishte Gjermania", ka deklaruar Hoti.

DELEGACIONI I BQK-së TAKOHET ME DREJTUESIT E DEPARTAMENTIT PËR TREGJET E PARASË DHE KAPITALIT TË FMN-së

PRISHTINË, 15 PRILL - Delegacioni i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), i kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili me bashkëpunëtorë, ka zhvilluar takim me ekipin e Departamentit për Tregjet e Parasë dhe Kapitalit (MCM) në Fondin Monetar Ndërkombëtar të kryesuar nga Mary Goodman, ndihmësdrejtorëshë dhe shefe e Divizionit të Departamentit për Tregjet Monetare dhe të Kapitalit (MCM) në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), së bashku me ekipin e gjerë të ekspertëve të fushave të ndryshme që janë të angazhuar në projektet e asistencës teknike. Gjatë takimit u diskutua mbi ecurinë e rekomandimeve të



dhëna nga misionet paraprake të FMN-së, përfshirë Rishikimin e Stabilitetit të Sektorit Financiar (FSSR), Vlerësimin e Masave Mbrojtëse (Safeguard Assessment), si dhe nivelin e

zbatimit të asistencave teknike të ofruara deri më tani, që u vlerësuan lart dhe me performancë të lartë. Këto projekte janë të lidhura drejtpërdrejt me planin

strategjik dhe kryesisht lidhen me mandatin parësor të BQK-së. Në veçanti u diskutua për vazhdimin e mbështetjes së FMN-së në fushat e mbikëqyrjes bankare, stabilitetit financiar, sigurisë kibernetike si dhe avancimin e kornizës institucionale dhe ligjore të BQK-së.

Theksi u vendos te mbështetja për zbatimin e Procesit të Rishikimit Mbikëqyrës (SREP), Kodin e Transparencës për BQK-në, zhvillimin e mëtejshëm të modeleve në fushën e menaxhimit të krizave si dhe avancimin e mbikëqyrjes së TI-së dhe menaxhimit të rreziqeve kibernetike në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Guvernatori i BQK-së shprehu vlerësimin dhe mirënjohjen e lartë ndaj FMN-së, ku vetëm në dy vitet e fundit numri i projekteve të përbashkëta ka tejkaluar dhjetë asistencë profesionale në fusha të përmendura më lart, me një nivel të lartë të zbatimit dhe të vlerësuar lart nga FMN. Në kuadër të vizitës zyrtare në Uashington DC, delegacioni i BQK-së do të ketë edhe takime bilaterale me drejtuesit e institucioneve partnere ndërkombëtare të cilat janë të përfshira në zbatimin e reformave në legjislacion dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale në zbatim të mandatit dhe objektivat e institucionit.

Bie për 2 cent çmimi i naftës në Kosovë

PRISHTINË, 15 PRILL - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka publikuar të mërkurën çmimet e reja maksimale të lejuara për derivatet e naftës. Sipas njoftimit

të MINTI-t, këto ishin çmimet për 15 prill: Nafta (dizel): 1.76 euro/litër, Benzina: 1.44 euro/litër dhe Gazi: 0.89 euro/litër. Krahasuar me ditën e djeshme, çmimi i naftës ka

shënuar rënie prej 2 centësh për litër, ndërsa benzina dhe gazi kanë mbetur të pandryshuara. Kjo rënie e çmimeve vjen pas luhatjeve të fundit në tregun e derivateve dhe pritet të reflektojë

lehtësim të lehtë për konsumatorët.

Ministria vazhdon ta monitorojë tregun e derivateve për të siguruar stabilitet të çmimeve dhe mbrojtje të konsumatorëve.



GAFA, SHPËRTHIME DHE DEKLARATA TË TEPRUARA. DONALD TRUMP, MES NARCIZMIT DHE HUMBJES SË KONTROLLIT

Edhe ekspertët shprehen hapur: Donald Trump po shfaq “narcizëm dhe humbje kontrolli”.
Gjuha e drejtpërdrejtë që ishte forca e tij, tani është bërë kundërproduktive

NEW YORK – Nuk ishte vetëm përplasja me Papa Leonin, nga e cila doli i dëmtuar rëndë: prej Donald Trumpit, gjatë muajve dhe javëve të fundit, kemi parë një seri mbresëlënëse daljesh vetëshkatërruese në planin e komunikimit. Bëhet fjalë për një humbje progresive të kontaktit emocional me opinionin publik, që pati kulmin e saj më të qartë gjatë incidenteve të ICE në Minneapolis. Më pas, gjërat vetëm janë përkeqësuar. Sot shqetëson mbi të gjitha mungesa e frenave në deklaratat e tij, gjithnjë e më ekstreme dhe hiperbolike, mania e madhësisë dhe prirja për t'u përplasur me këdo, shpesh me vulgaritet të papranueshëm. Fraza si “do t'i kthejmë ata bijtë e k... në epokën e gurit”, referuar iranianëve, janë vetëm një shembull i një problemi presidencial që po merr konture patologjike dhe që nuk funksionon më: ajo gjuhë e drejtpërdrejtë dhe agresive, që për vite me radhë ishte forca e tij komunikuese, sot duket e konsumuar dhe kundërproduktive. Problemi është se ai nuk e kupton që ka një qëndrim vetëshkatërrues. Këtë e konfirmojnë edhe sondazhet, me norma miratimi rreth 40% dhe madje 34% në një rast, shifra të paprecedenta për një president në prag të zgjedhjeve të mesmandatit, që nuk premtojnë mirë dhe krijojnë një spirale negative në sjelljen e tij. Në një sondazh të Reuters, 60% e të anketuarve vënë në dyshim qartësinë mendore dhe aftësinë e Trump për të qenë president, për shkak të moshës.

Megalomania e Donald Trump

Kjo nuk është një dinamikë e re. Shenjat e padurimit vërehen jo vetëm në marrëdhëniet politike, por pothuajse në çdo nismë të presidentit. Që nga transformimi i njëanshëm i hapësirave historike të Shtëpisë së Bardhë, deri te ideja për një hark monumental gjigant për të festuar 250-vjetorin e pavarësisë, apo njoftimi për një dollar argjendi me portretin e tij (i ndaluar për një president në detyrë), si dhe shtimi i firmës së tij në kartëmonedha, të gjitha këto janë gjëra të diskutueshme në shije dhe tregojnë një personalizim në rritje të pushtetit, për më tepër të paprecedentë. Tipari dallues mbetet rrëfimi i suksesit individual: bindja se



mund të veprojë i vetëm, mbi çdo ndërmjetësim. Në këtë kuptim, edhe ideja e harkut monumental është domethënëse.

Dorëzimi i projektit përmes një konkursi mes arkitektëve të mëdhenj, si Richard Meier, Peter Eisenman apo Frank Gehry, mund të ishte kthyer në një simbol bashkëkohor të përbashkët. Por në versionin aktual jemi larg një interpretimi kulturor modern, për një arsye të thjeshtë: jo vetëm që kjo lloj qasjeje nuk i përket atij, por do të ishte bërë “monumenti i tyre”, i arkitektëve dhe amerikanëve, jo i tij. Ekziston edhe një devijim institucional: mjafton të kujtojmë sulmet ndaj kreut të Rezervës Federale, Jerome Powell, të rrëzuara nga gjykatat, si dhe humbjen e fundit në gjykatë kundër Wall Street Journal dhe Murdoch, të cilit i kërkonte 10 miliardë dollarë për fyerje. Prirja për konflikt nuk e ndihmon më. Dhe pas përplasjes me Papa Leonin, ai publikon një imazh

të vetes si Jezusi që shëron të sëmurët, sikur të mund të fitonte në rrjetet sociale duke u shpallur Zot.


Fatkeqësisht, imazhi qesharak në vetvete, nuk u pëlqye jo vetëm nga katolikët, por edhe nga komunitete të tjera të krishtera.

Debati klinik

Kritikat nuk vijnë më vetëm nga opozita. Zëra autoritarë brenda vetë lëvizjes MAGA e kanë sulmuar Donald Trump. Përplasja me Leonin solli një reagim të bashkuar nga Kisha katolike amerikane, me ndërhyrje publike të ipeshkvijve dhe kardinalëve, të cilët i cilësuan të papërshtatshme tonet dhe përmbajtjen, duke theksuar distancën mes rolit institucional dhe mënyrës së sjelljes së presidentit. Paralelisht, debati është zgjeruar edhe në planin klinik. Figura me ndikim si John Gartner, psikolog klinik dhe ish-profesor në Johns Hopkins,

i atribuon Donald Trump “narcizëm malinj” dhe shpjegojnë se kemi të bëjmë me një konfigurim personaliteti destruktiv, më shumë sesa një çrregullim të thjeshtë klinik. Të tjerë theksojnë nevojën për të shmangur diagnozat nga distanca. Megjithatë, mbetet një perceptim i përhapur për një shkëputje në sjelljen presidenciale, e dukshme edhe në komunikim, shpesh i fragmentuar dhe i përsëritur, me vështirësi për të ruajtur një linjë të qëndrueshme në kohë. A kishte nevojë të sulmonte Georgia Melonin, e cila i kishte treguar miqësi? Sigurisht që jo, por edhe këtu del në pah një qëndrim vetëshkatërrues. Shtëpia e Bardhë i hedh poshtë këto interpretime, duke pretenduar se paparashikueshmëria është një strategji e qëllimshme. Por zhvillimet e fundit kanë rihapur pyetje më të gjera mbi aftësinë e lidërshiptit në një kontekst ndërkombëtar të paqëndrueshëm, ku koherenca

dhe besueshmëria janë thelbësore. Siç shkroi New York Times, “shpërthimet e presidentit kanë ngritur pikëpyetje mbi lidërshiptin amerikan në kohë lufte”. Dhe si përgjigjet Donald Trump? Duke e çuar gjithmonë më tej përplasjen, me një stil që favorizon konfrontimin e drejtpërdrejtë dhe polarizimin. Toni nuk ndryshon dhe nuk tërhiqet: duke folur për ish-aleatët e tij si Tucker Carlson apo të tjerë që e kanë kritikuar, ai përdor receta të thjeshta: “Janë njerëz budallenj, e dinë vetë, e dinë familjet e tyre dhe e dinë të gjithë!... Janë të çmendur, nxitës trazirash dhe do të thonë çdo gjë për pak publicitet të lirë”. Fatkeqësisht për të, përballë nuk ka vetëm rezistencë gjithnjë e më të madhe, por edhe një amerikan tjetër, Papa Leoni, i cili papritur e ka bërë të duket më i vogël. Por për të nuk ka problem: do t'i mohojë të gjitha. Edhe fjalën e Zotit. Dhe në mendjen e tij, njerëzit bëjnë mirë ta dëgjojnë. / Corriere della Sera – Bota.al



Kosova synon medalje në Kampionatin Evropian të Xhudos

PRISHTINË, 15 PRILL - Në Tibilisi të Gjeorgjisë sot (e enjte) do të nisë Kampionati Evropian i Xhudos për seniorë. Në këtë kampionat Republika e Kosovës do të përfaqësohet me gjashtë xhudistë. Në këtë ngjarje të rëndësishme të xhudos

evropiane Kosova synon paraqitje të suksesshme përballë konkurrencës së fortë ndërkombëtare. Në këtë kampionat do të garojnë Erza Muminoviq në kategorinë -48 kg, Distria Krasniqi e Fatjona Kasapi në -52 kg, Laura Fazliu

në -63 kg, Akil Gjakova dhe Dardan Cena në kategorinë -73 kg. Ekipi i Kosovës udhëhiqet nga trajnerët Driton Kuka dhe Majlinda Kelmendi. Gara pritet të jetë mjaft konkurruese, me pjesëmarrjen e rreth 400 garuesve,

përkatësisht 227 meshkuj dhe 173 femra nga 46 shtete. Në ditën e parë do të ndeshen Distria Krasniqi, Erza Muminoviq dhe Fatjona Kasapi, ndërsa të premtën në tatami do të dalin Laura Fazliu, Akil Gjakova dhe Dardan Cena.



“DARDANET” VAZHDOJNË SERINË POZITIVE, MPOSHTIN BULLGARINË NË SOFJE

PRISHTINË, 15 PRILL - Kombëtarja e Kosovës në konkurrencën e vazhdate ka vazhduar serinë pozitive në kualifikimet për Kupën e Botës 2027, duke shënuar fitore të rëndësishme në udhëtim ndaj Bullgarisë me rezultat 3:1. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin “Aleksandar Shalamanov” në Sofje nisi më mirë për vendasit, të cilat kanë kaluar në epërsi në minutën e 9 me golin e Aleksandra Yaneva. Megjithatë, reagimi i “dardaneve” ishte i menjëhershëm. Në minutën e 15-të, pas një goditjeje nga këndi, kapitenia Erëleta Memeti ka realizuar gol të bukur për ta barazuar

rezultatit në 1:1. Vetëm gjashtë minuta më vonë Kosova ka përmbysur rezultatit. Pas një krosimi të saktë, mbrojtësja Blerta Smaili ka realizuar me kokë për epërsinë 2:1, rezultat me të cilin përfundoi pjesa e parë. Në pjesën e dytë “dardanet” kontrolluan lojën dhe krijuan më shumë raste shënimi. Epilogu i ndeshjes u vulos në minutën e 89, kur pas një tollovie në zonë, mbrojtësja Albulena Fejza realizoi për rezultatit përfundimtar 3:1. Kosova ka dominuar edhe në statistika, duke krijuar 13 raste për gol, krahasuar me vetëm tri të vendasve si dhe katër goditje në portë kundrejt dy të



Bullgarisë. Me këtë fitore Kosova ka forcuar pozitën e parë në Grupin C2, me nëntë pikë nga

tri ndeshje, pas fitoreve të mëparshme ndaj Gjibraltarit (6:0) dhe Kroacisë (1:0). “Dardanet” do të përballen sërish me Bullgarinë pas katër ditësh, kësaj radhe në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Nga Liga C nuk sigurohet kualifikimi direkt për në Kupën e Botës, por vendi i parë garanton pjesëmarrjen në “play-off”-in kualifikues dhe promovimin në Ligën B të Ligës së Kombeve, që mbetet objektivi kryesor i Kombëtares së Kosovës. Menjëherë pas kësaj ndeshje, presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka uruar

futbollistët për këtë fitore. “Vashat tona treguan karakter të lartë dhe pas disavantazhit u rikthyen fuqishëm me tri gola për ta vazhduar serinë pozitive. Ky është një hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së objektivit për promovim në Ligën B, i cili tashmë është gjithnjë e më afër. Megjithatë, rrugëtimi duhet të vazhdojë me të njëjtin përkushtim, seriozitet dhe fokus deri në fund. Përgëzime për lojtaret dhe stafin teknik në krye me Sami Sermaxhajin për angazhimin dhe profesionalizmin e treguar. Sukseset dhe mbarësi në ndeshjet e ardhshme!”, ka shkruar Ademi në rrjetet sociale.

ADEMI KËRKON PËRSHPEJTIMIN E PUNIMEVE NË STADIUMIN “ADEM JASHARI”

MITROVICË, 15 PRILL - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, i ka bërë thirrje Ministrisë së Sportit dhe Rinisë të mos ketë më vonesa në investimin për stadiumin “Adem Jashari”, duke theksuar nevojën urgjente për një stadium të dytë që plotëson standardet ndërkombëtare. Aktualisht Kosova ka në dispozicion vetëm stadiumin “Fadil Vokrri” për ndeshje ndërkombëtare, një situatë që, sipas Ademit, paraqet rrezik serioz nëse nuk gjenden alternativa. Ademi ka zhvilluar

një vizitë në Mitrovicë, ku ka diskutuar për përmirësimin e infrastrukturës së futbollit në këtë zonë. Gjatë kësaj vizite ai ka takuar kryetarin e ri të komunës, Faton Peci, me të cilin ka biseduar për nevojën e ndërtimit të fushave të reja të futbollit, duke theksuar mungesën e tyre në Mitrovicë. “U dakorduam që të ndërmarrim hapa konkretë për ndërtimin e fushave të reja. Kërkova nga komuna që të identifikojë parcelat e nevojshme, ndërsa ne si Federatë jemi të gatshëm të

kontribuojmë”, ka deklaruar Ademi. Ai ka theksuar se FFK-ja ka kapacitet që një fushë futbollit ta ndërtojë brenda tridhjetë ditësh. Në fokus të diskutimeve ka qenë edhe përmirësimi i stadioneve në këtë qytet. Ademi ka përmendur nevojën për ndërhyrje në stadiumin “Riza Lushta” si dhe ndërtimin e një fushe stërvitore. Njëkohësisht ai ka kërkuar përshpejtimin e punimeve në stadiumin “Adem Jashari”, i cili është në renovim prej vitësh. “Kërkoj nga Ministria e Sportit



dhe të gjithë të përfshirët që të mos ketë neglizhencë, pasi çdo vonesë mund të na detyrojë të zhvillojmë ndeshje jashtë vendit”, ka thënë Ademi, duke shtuar se aktualisht Kosova ka vetëm një stadium për garat

evropiane. Vizita është vazhduar edhe në objektin sportiv “Fatime Xhaka”, ku është vendosur që ky objekt të kalojë në shfrytëzim të Federatës së Futbollit të Kosovës. Aty do të vendoset selia e Lidhjes Rajonale të Futbollit të Mitrovicës dhe fusha ekzistuese do të rinovohet për t’u përdorur nga grupmoshat e reja. Ademi ka theksuar se FFK-ja do ta vazhdojë angazhimin për krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e futbollit në të gjithë Kosovën.

Barcelona dhe Liverpooli eliminohen nga Liga e Kampionëve

MADRID, 15 PRILL - Skuadra e Barcelonës dhe Liverpooli kanë mbyllur rrugëtimin në Ligën e Kampionëve, pasi janë eliminuar në çerekfinale nga Atletico Madridi dhe Paris Sanit-Germanini (PSG). Atletico ka avancuar në gjysmëfinale të Championsit me rezultatit e përgjithshëm 3:2 pas dy ndeshjeve të luajtura.

Duelin e parë, Atletico e ka fituar 2:0 në “Camp Nou”, ndërsa të kthimit e ka humbur 2:1 në shtëpi. Barcelona ka triumfuar në “Wanda Metropolitano”, por fitorja nuk ishte e mjaftueshme për kualifikim në gjysmëfinale. Të tre golat në duelin e kthimit janë shënuar në pjesën e parë, ndërsa në të dytën është

anuluar një gol i Barçës. Lamine Yamal (4’) e Ferran Torres (24’) kanë shënuar për Barcelonën, kurse Ademola Lookman (31’) ka realizuar për Atleticon. Edhe kampioni në fuqi i Evropës, Paris Sanit-Germanini (PSG), ka avancuar në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Në çerekfinale

PSG-ja ka fituar dy ndeshjet ndaj Liverpoolit me rezultat identik për të kaluar tutje. Pas fitores 2:0 javën e shkuar në Francë, PSG-ja ka triumfuar 2:0 për ta konfirmuar eliminimin e Liverpoolit. Sulmuesi Ousmane Dembele ka shënuar të dy golat falë asistimeve të Kвича Kvaratskhelia dhe Bradley Barcola. Dembele ka realizuar



në minutën e 72-të dhe në minutën e 91-të për fitoren dhe kualifikimin e PSG-së në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Grida” SH.P.K. pronar Norik Osmani me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812358324 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Grida” D.O.O. Norik Osmani Gnjilane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812358324 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Grida” L.L.C. with owner Norik Osmani with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812358324 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kinderhaus Mitrovicë” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812331106 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kinderhaus Mitrovicë” D.O.O. Mitrovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812331106 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Kinderhaus Mitrovicë” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812331106 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me nr. Fiskal 600181846, bënë ndryshimin e emërimit në Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, me të njëjtin numër Fiskal: 600181846.

- Basri F. Berisha B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit “Cffe Bar n’Mahallë” me nr. Unik Identifikues: 811365487.

- Mesad Group Europe L.L.C. M.G.E. Stone shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812384303.

- Arjan Tërtini shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gjon Buzuku” Prizren.

- Asllan Rama B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 812336205 të lëshuar nga ARBK.

- Arbnore Gashi shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.E. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Dijamant Zeqiri B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810018061.

- Muharrem Miftari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Silvira Tomazini” gjimnazi “Frang Bardhi” Mitrovicë.

- Safet I. Mehana B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 811313220.

- Rilind Sope shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Mergin Lutfi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Festim Morina shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Hetem Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trimi” SH.P.K. gjatë orarit të punës. Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.

- Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Dino Mineral" Sh.p.k. Lipjan në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Bazën e prodhimit të asfaltit në Koretishë - Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.06.2026 në ora 09:00 në Sallën e Kulturës në Koretishë, Komuna e Novobërdës, do të organizohet debat publik nga "Dino Mineral" Sh.p.k. Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Dino Mineral" Sh.p.k. Lipjan - për Bazën e prodhimit të asfaltit në Koretishë - Novobërdë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Dino Mineral" Sh.p.k. Lipjan në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Bazën e prodhimit të betonit në Koretishë - Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.06.2026 në ora 10:00 në Sallën e Kulturës në Koretishë, Komuna e Novobërdës, do të organizohet debat publik nga "Dino Mineral" Sh.p.k. Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Dino Mineral" Sh.p.k. Lipjan - për Bazën e prodhimit të betonit në Koretishë - Novobërdë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Dino Mineral" Sh.p.k. Lipjan në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror të mermerizuar në Koretishë - Novobërdë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.06.2026 në ora 11:00 në Sallën e Kulturës në Koretishë, Komuna e Novobërdës, do të organizohet debat publik nga "Dino Mineral" Sh.p.k. Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Dino Mineral" Sh.p.k. Lipjan - për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror të mermerizuar në Koretishë - Novobërdë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 568/1

Dt: 15.04.2026

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, neni 81 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Rregullores (Qrk) Nr:19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita:	Vend i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitive	Koeficienti i pagës
ShML	Qendra e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë	Prishtinë	Instruktur për Ndërmarrësi	Vend i lirë	1	6.8

I. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njëri nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike).

II. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Çertifikatat e trajnimeve;
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Për instruktor me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në ndërmarrje, biznese dhe institucione tjera (dëshmi të përvojës së punës: vërtetim ose kontratat e punës);
- Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre.

III. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it: UA Nr. 05/2015, Rregullores (Qrk) Nr:19/2024, si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për Instruktur

- Kualifikimi: Baçelor

IV. Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktur:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.

- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:
- Testit me shkrim, i cili përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë.
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbënë 50% të vlerësimit të përgjithshëm.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitat e lartpërmendura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail, do të publikohen në tabelën e njoftimeve dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

VI. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes nga data 16.04.2026 deri me 15.05.2026.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollën përkatëse;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me afëtesi të kufizuar inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

